


UDHËZUES METODIK

“Përgatitja, Zbatimi dhe Monitorimi i Buxhetit nga Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”



UDHËZUES METODIK

“Përgatitja, Zbatimi dhe Monitorimi i Buxhetit nga Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor”

Volumi III

Prill 2018

Hartoi:

Ana Tartaraj, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale

Bajram Caka, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Me mbështetjen e:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Udhëzues Metodik

“Për përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit nga qendrat shëndetësore të kujdesit parësor”

Ky udhëzues metodik është hartuar për të ndihmuar stafin e çdo qendre shëndetësore të kujdesit parësor për përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit. Në këtë dokument përcaktohen hapat që duhet të ndjekë çdo qendër shëndetësore duke filluar nga përgatitja e programit buxhetor afatmesëm e deri tek analiza e treguesve të monitorimit lidhur me zbatimin e buxhetit. Gjithashtu, jepen shembuj konkretë për përgatitjen e shifrave të buxhetit, detajimit mujor të tij, raportimit të realizimit mujor e progresiv. Hartimi i këtij udhëzimi metodik është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë.

I. HYRJE

Ç'është buxheti?

Buxheti i shtetit është dokumenti ekonomik kryesor i shtetit. Ai bazohet në përlllogaritjen e situatës fiskale në vend. Në totalin e fondeve të buxhetit të shtetit ka një fond të përcaktuar për sektorin shëndetësor. Fondet korente (paga, sigurime, mallra e shërbime) për qendrat shëndetësore të kujdesit parësor janë pjesë e buxhetit të sigurimeve shëndetësore të cilat miratohen si buxhet i veçantë në ligjin e buxhetit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale për qendrat shëndetësore janë pjesë e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Viti buxhetor në Shqipëri është i njëjtë me vitin kalendarik, domethënë zgjat nga 1 janari deri në 31 dhjetor.

Ligji bazë, i cili përcakton rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, është ligji nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Zakonisht, kur shpjegohet koncepti i buxhetit, marrim si shembull buxhetin e një individi ose të një familjeje. Të pasurit e parave është një nga kushtet kryesore për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e një individi ose familjeje. Përgjithësisht, paratë janë më të pakta ose të kufizuara krahasuar me dëshirat dhe nevojat për të shpenzuar. Nisur nga sa më sipër, është i nevojshëm priorizimi i objektivave.

Buxheti i shtetit është programi financiar i cili miratohet në Kuvend. Buxheti zakonisht aprovohet në dhjetor, domethënë para fillimit të vitit buxhetor.

Parimi bazë i hartimit të buxhetit është ai i balancimit të të ardhurave me shpenzimet, pra të ardhurat duhet të jenë të barabarta me shpenzimet. Kur të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet, buxheti është me tepicë, ndërsa, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat kemi deficit ose krijim detyrimesh të prapambetura.

Për qëllime të ndryshme, shpenzimet klasifikohen përgjithësisht sipas kategorive të mëposhtme:

- Ekonomike, për raporte statistikore dhe kontrolli.
- Funksionale, për analiza politikash dhe analiza historike.
- Administrative, për përgjegjshmëri në administrimin e buxhetit.
- Programuese, për formulim politikash.

Klasifikimi ekonomik është i nevojshëm për të analizuar buxhetin dhe për të nxjerrë tregues të krahasueshëm. Për shembull, përqindja e shpenzimeve për paga ndaj totalit të shpenzimeve. Kategoritë kryesore të shpenzimeve sipas këtij klasifikimi janë:

1. Shpenzimet korente
2. Shpenzimet kapitale

I. Shpenzimet korente

Shpenzimet korente përfshijnë shpenzimet për shërbimet dhe sendet e konsumueshme (në më pak se një vit), që janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Në këtë kategori futen:

- a) Shpenzimet për pagat, të cilat përfshijnë ato shpenzime që kryhen për personelin, si pagat bruto për personelin e përhershëm, pagat bruto për personelin e përkohshëm, kompensimet që jepen në formën e pagës, apo shpërblimet për personelin, për rezultate të larta në punë e të tjera të këtij lloji sipas legjislacionit në fuqi.
- b) Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas përqindjeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- c) Mallrat dhe shërbimet (ose operativet e mirëmbajtjes), të cilat përfshijnë të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve apo kryerjen e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e institucionit. Për shembull, blerje medikamentesh, blerje materialesh mjekimi, pagesa për ujë, energji elektrike, shpenzime të sigurisë dhe ruajtjes, shpenzime mirëmbajtjeje godine etj. Këtu nuk përfshihen shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme.
Në rastin kur një artikull nuk plotëson njërin nga kushtet (kufirin e vlerës “10,000 lekë” ose jetëgjatësinë mbi 1 vit) për të qenë aktiv i qëndrueshëm (kushte këto të vendosura sipas legjislacionit kontabël në fuqi), mbetet në kompetencë të titullarit të institucionit konsiderimi i shpenzimit për blerjen e këtij artikulli si shpenzim korent apo shpenzim për investime.
- d) Transferimet korente të brendshme, përfshijnë transferimet te nivelet e tjera të qeverisjes si për shembull, transferta që buxheti i shtetit alokon për Fondin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. Qendrat shëndetësore e marrin buxhetin e tyre si pjesë e kësaj transferte.
- e) Transferimet korente të huaja, të cilat përfshijnë transferimet tek institucionet apo individët jo rezidentë të huaj.

II. Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale përfshijnë vetëm shpenzimet për sendet dhe shërbimet me afat përdorimi mbi një vit.

Në këtë kategori përfshihen këto shpenzime:

- a) Shpenzimet Kapitale të Grupëzuara, të cilat përfshijnë shpenzimet për: (i) studimin e fizibiliteteve; (ii) Përgatitjen e planeve; (iii) trajnimin dhe (iv) administrimin e projekteve.
- b) Shpenzimet Kapitale të Trupëzuara, të cilat përfshijnë koston e blerjes së pajisjeve, ndërtimit dhe rehabilitimit të tyre.

Bashkëlidhur në aneksin nr. 1 do të gjeni strukturën e shpenzimeve, e cila është botuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

Klasifikimi funksional. Sipas këtij klasifikimi, shpenzimet paraqiten sipas njësive administrative që kanë përdorur fondet. Për shembull, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është gr. 13. Ky klasifikim ka për qëllim të tregojë shumën e fondeve të përdorura në arsim, shëndetësi, drejtësi etj. Sipas këtij klasifikimi, shpenzimet për shëndetësinë zënë rreth 10% të totalit të buxhetit të shtetit.

Klasifikimi sipas programeve. Një program përbëhet nga disa aktivitete apo projekte. Një program ka një buxhet të përcaktuar qartë dhe përfshin disa aktivitete. Politikat drejtohen nga objektiva dhe qëllime më të përgjithshme. Ky klasifikim shërben për dy qëllime: (i) për përcaktimin dhe qartësimin e objektivave dhe politikave; (ii) kontrollin e realizimit nëpërmjet plotësimit të treguesve.

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale menaxhon tetë programe buxhetore nga të cilat katër kanë lidhje me shëndetësinë. Këto janë (i) Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor; (ii) Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor; (iii) Shërbime të shëndetit publik; (iv) Shërbimi kombëtar i urgjencës mjekësore.

Procesi buxhetor

Procesi i përgatitjes së buxhetit fillon me hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm. Në Ligjin nr.9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" çdo institucion është i detyruar të hartojë dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm. Në këtë dokument janë përshkruar objektiva e aktivitete për tre vite, për secilin nga programet. Me anë të VKM-ve, çdo vit miratohen kufijtë e shpenzimeve për secilën ministri. Ministria shpërndan këtë shumë sipas programeve, bazuar në politikat e saj. Për objektiva të cilat mbeten të pa financuara, ajo ka të drejtë të kërkojë shtesë për fonde, sigurisht bazuar në një relacion të argumentuar.

Ky proces fillon në muajin mars të vitit paraardhës. Deri sa buxheti miratohet në Kuvend është një proces diskutimesh midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konkretisht, për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor për vitin 2017 Ministria e Shëndetësisë në Projekt Buxhetin Afatmesëm ka pasur si objektiva:

1. Përmirësimin e shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve për të paktën 475.000 persona që do të kryejnë kontrollin mjekësor bazë periodik.
2. Përmirësimin e ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit së skemës së medikamenteve nga 490 në vitin 2016 në 576 në vitin 2017.
3. Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit parësor për popullatën e regjistruar (3 milionë banorë) tek mjeku i familjes.
4. Përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve në këshillimoren e gruas dhe fëmijës nëpërmjet shtimit të vizitave të realizuara sipas standardeve nga 234.000 vizita në vitin 2016 në 250.000 vizita në vitin 2017.

Për secilin nga objektivat e mësipërme janë parashikuar edhe shpenzimet e nevojshme:

- Për objektivin e parë është parashikuar 877.000.000 lekë, ndërsa numri i popullsisë që do të përfitojë këtë shërbim është 475.000 banorë.
- Për objektivin e dytë është parashikuar 4.611.132.000 lekë, ndërsa numri i medikamenteve në listën e rimbursimit është 576 medikamente.
- Për objektivin e tretë është parashikuar 2.620.000.000 lekë ndërsa numri i vizitave të parashikuara në kujdesin parësor 6.100.000 vizita.
- Për objektivin e katërt është parashikuar 319.000.000 lekë për 250.000 numër vizitash në këshillimoren e gruas dhe fëmijës.

Në muajin Korrik të çdo viti, pasi është dërguar drafti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm në Ministrinë e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pjesën e shpenzimeve kapitale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për pjesën e shpenzimeve korente, dërgojnë udhëzimet përkatëse pranë njësisive të tyre vartëse (DSHP/DRFSDKSH) për hartimin e Projekt Buxhetit të vitit pasardhës dhe një parashikim për dy vitet e tjera të PBA-së. DSHP/DRFSDKSH u dërgojnë qendrave shëndetësore udhëzimin përkatës dhe tabelat që duhet të plotësohen prej tyre lidhur me projektbuxhetin.

Bashkëlidhur në aneksin nr. 2 do të gjeni formatet standarde të hartimit të projektbuxhetit.

Si duhet të veprojnë qendra shëndetësore për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm me marrjen e udhëzimeve përkatëse?

Drejtori i qendrës shëndetësore me urdhër me shkrim krijon grupin e punës për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm. Në grupin e punës përfshihen:

- Drejtori i QSH-së
- Ekonomisti
- Juristi (në rastet kur qendra shëndetësore ka jurist në organikë)
- Kryeinfermieri
- Një ose dy punonjës (mjek, infermier) me përvojë

Grupi i punës i ngarkuar për të përgatitur projektbuxhetin duhet të ndjekë etapat e mëposhtme:

1. Të listojë zërat e shpenzimeve të qendrës shëndetësore
2. Të grupojë zërat e përafërt
3. Të vlerësojë **koston për njësi** për zërat e buxhetit si dhe **koston vjetore të tyre**
4. Të listojë burimet e mundshme të të ardhurave (buxheti, të ardhurat dytësore, donatorët)
5. Të përgatisë buxhetin sipas formateve të dërguara në udhëzim dhe relacionin argumentues
6. Të përgatisë relacion për kërkesat shtesë në rast se ka të tilla

Të dhënat që mbledh grupi i punës për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm:

- a) Realizimin e buxhetit të vitit të mëparshëm (paga e shpërblime, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, mallra e shërbime për çdo zë shpenzimi, realizimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore). Tepricën e fondeve të papërdorura nga buxheti i kontraktuar me Fondin dhe të ardhurat dytësore në fund të vitit të mëparshëm.
- b) Realizimin e buxhetit për 6-mujorin e parë të vitit aktual (paga e shpërblime, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, mallra e shërbime për çdo zë shpenzimi, realizimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore). Tepricën e fondeve të papërdorura nga buxheti i kontraktuar me Fondin dhe të ardhurat dytësore në fund të 6-mujorit të parë të vitit aktual.
- c) Strukturën organike të QSH-së për vitin e mëparshëm dhe 6-mujorin e parë të vitit aktual, numrin e punonjësve sipas profesioneve. Vjetërsinë në punë për çdo punonjës.
- d) Listën e barnave dhe materialeve mjekësore të urgjencës mjekësore dhe sasitë e konsumuara gjatë vitit të mëparshëm dhe 6-mujorit të parë të vitit aktual, si dhe gjendjen fizike të tyre në fund të 6-mujorit të parë të vitit aktual.
- e) Numrin e banorëve që ka mbuluar çdo mjek gjatë vitit të mëparshëm dhe 6-mujorin e parë të vitit aktual. Klasifikimin e mjekëve, për të rritur, për gjithë grupmoshat, për grupmoshat pediatrike.

- f)** Realizimin e numrit të vizitave dhe indikatorëve të tjerë nga çdo mjek gjatë vitit të mëparshëm dhe 6-mujorit të parë të vitit aktual.
- g)** Buxhetin e planifikuar në total dhe për çdo zë shpenzimi për vitin aktual.
- h)** Konsumin e materialeve të ndryshme (materiale pastrimi, shtypshkrime, kancelari, inventar i imët) për vitin e mëparshëm, 6-mujorin e parë të vitit aktual dhe gjendjen fizike të tyre në QSH në fund të 6-mujorit të parë të vitit aktual.
- i)** Paketat e shpërblimeve që jep qendra shëndetësore mbështetur në udhëzimet në fuqi.

Mbështetur në të dhënat e mësipërme, në realizimin e 6-mujorit të parë të vitit aktual dhe buxhetin e planifikuar të këtij viti, grupi i punës përgatit realizimin e pritshëm për vitin aktual. Në përgatitjen e realizimit të pritshëm duhet të mbahet parasysh se kufijtë maksimalë të shpenzimeve sipas buxhetit të vitit aktual, janë kufij maksimalë dhe në asnjë rast nuk duhet të parashikohen me tejkalim.

Planifikimi i shpenzimeve për vitin e ardhshëm fillon me pagat dhe sigurimet shoqërore. Ky parashikim bëhet bazuar në nivelin e pagave sipas legjislacionit dhe strukturës organike në fuqi.

II. Parashikimi i fondit të pagave dhe shpërblimeve

Parashikimi i këtij treguesi duhet të mbështetet:

- Në numrin e punonjësve të qendrës shëndetësore sipas profesioneve dhe pozicioneve të punës që mbulojnë. Pagat e punonjësve të qendrave shëndetësore miratohen nga Këshilli Administrativ i Fondit me udhëzim të veçantë. Aktualisht, është në fuqi Udhëzimi Nr. 1 datë 03.05.2017 "Për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e qendrave shëndetësore nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor". Struktura e pagës është si më poshtë:

A) Për mjekët e përgjithshëm dhe të familjes

1. Paga bazë për detyrime të përgjithshme profilaktike, higjieno-sanitare e shërbime shëndetësore parandaluese. Kjo pagë është fikse dhe caktohet me Udhëzim të Këshillit Administrativ të Fondit, aktualisht është **14,000 lekë në muaj**.
2. Shtesë për vjetërsinë në punë në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vite. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën bazë dhe aktualisht është **280 lekë/muaj**. Shtesa maksimale që mund të përfitojë një mjek sot, për efekt të vjetërsisë në punë është 7,000 lekë në muaj. (14,000 x 2% x 25 vite).
3. Shtesë për specializime pasuniversitare, sipas dëshmive të lëshuara nga Fakulteti i Mjekësisë, vetëm për mjekët patologë, pediatër dhe të familjes. Aktualisht është **5,000 lekë në muaj**.
4. Shtesë për ngarkesën **për banorë**, sipas tarifave të mëposhtme (aktualisht):
 - i. për mjekun për të rritur është 9.7 lekë. Një mjek me ngarkesë 2,000 banorë përfiton shtesë page 19,400 lekë në muaj. (2,000 banorë x 9.7 lekë/banorë).
 - ii. për mjekun e përgjithshëm e familjes për grupmoshat pediatrike është 19.4 lekë. Një mjek me ngarkesë 1,500 banorë përfiton shtesë page 29,100 lekë në muaj. (1,500 banorë x 19.4 lekë/banorë).
 - iii. për mjekun e përgjithshëm dhe të familjes për të gjitha grupmoshat është 10.7 lekë. Një mjek me ngarkesë 2,500 banorë përfiton shtesë page 26,750 lekë në muaj. (2,500 banorë x 10.7 lekë/banorë).
5. Shtesë për pozicionin gjeografik ku ndodhet qendra shëndetësore. Vlera e kësaj shtese jepet në aneksin përkatës të udhëzimit të Fondit. Sipas udhëzimit aktual mbështetur në pozicionin gjeografik, qendrat shëndetësore janë klasifikuar në pesë zona. Zona qendrore, ku shtesa është 20,000 lekë në muaj, zona fushore, ku shtesa është 27,000 lekë në muaj, zona kodrinore, ku shtesa është 30,000 lekë në muaj, zona malore, ku shtesa është 39,000 lekë në muaj dhe zona e thellë malore, ku shtesa është 47,000 lekë në muaj.

6. **Për qendrat shëndetësore të cilat kanë kontraktuar me Drejtorinë Rajonale të Fondit dhënien e shërbimit të pandërprerë.** Ato duhet të parashikojnë edhe shtesat mbi pagë që përfiton personeli mjekësor, kur jep shërbim të pandërprerë, mbështetur në masën e shpërblimit të përcaktuar në udhëzimin e Fondit. Aktualisht ky shpërblim mbi pagën:
- Kur jepet në ditët e zakonshme është 4,000 lekë.
 - Kur jepet ditën e shtunë është 3,500 lekë.
 - Kur jepet ditën e diel apo ditë festë është 3,000 lekë.

Parashikimi i këtij treguesi bëhet duke marrë në konsideratë kontratën që ka qendra shëndetësore për dhënien e shërbimit të pandërprerë, numrin e ditëve që jepet ky shërbim (pra 365 ditë gjithsej, nga të cilat 14 janë festa zyrtare, 52 ditë të shtuna, 52 ditë të diela) dhe masën e shpërblimit për dhënien e këtij shërbimi.

7. Qendrat shëndetësore të cilat kanë Komision Mjeko Ligjor (KML) apo mjekë që janë anëtarë të KML-ve duhet të llogaritin edhe shtesën e pagës për këta punonjës, duke marrë parasysh numrin e personelit të angazhuar në KML dhe shtesën e pagës të përcaktuara në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim, të cilat aktualisht janë:
- Për kryetarin e KML është 2,000 lekë në muaj.
 - Për anëtarin e KML është 1,800 lekë në muaj.

B) Për mjekun specialist dhe specialistët e lartë që punojnë në qendrën shëndetësore

1. Paga e grupit, i referohet nivelit të diplomës që ka mjeku specialist. Në udhëzimin e Fondit është përcaktuar që mjeku specialist që punon në QSH të ketë diplomën e grupit 1, pra Master Shkencor ose e barasvlershme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Aktualisht, paga e grupit është 14,000 lekë në muaj.
- Në udhëzimin e Fondit është parashikuar, paga e grupit për psikolog, punonjësit social, specialistit të lartë (jo mjek) që punojnë në QSH. Për t'u punësuar në pozicionet e mësipërme, niveli i diplomës që kërkohet është i grupit 1, 2 dhe 3. Për të përfituar pagesën e grupit 1 kërkohet diploma Master Shkencor ose e barasvlershme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Për të përfituar pagesën e grupit 2 kërkohet diploma Master Profesional ose e barasvlershme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Për të përfituar pagesën e grupit 3 kërkohet diploma Bachelor ose e barasvlershme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Pagat e grupit sipas nivelit të diplomës aktualisht janë: Master Shkencor (të barasvlershme me të) 14,000 lekë në muaj, Master Profesional (të barasvlershme me të) 11,000 lekë në muaj dhe Bachelor (të barasvlershme me të) 10,000 lekë në muaj.
2. Shtesë për vjetërsinë në punë në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vite. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën bazë dhe aktualisht është **280 lekë/muaj** për punonjësit me nivel diplome grupi 1 pra Master Shkencor, **220 lekë/muaj** për punonjësit me nivel diplome grupi 2 pra Master Profesional dhe **200 lekë/muaj** për punonjësit me nivel diplome grupi 3 pra Bachelor. Shtesa maksimale që mund të përfitojë sot një punonjës me diplomë Master Shkencor për efekt të vjetërsisë në punë është 7,000 lekë në muaj (14,000 x 2% x 25 vite), me diplomë Master Profesional është 5,500 lekë në muaj, me diplomë Bachelor është 5,000 lekë në muaj.

3. Shtesë për pozicion sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e Fondit. Aktualisht, shtesa për pozicion për mjekët specialist varion nga 38,500 lekë në 41,000 lekë në muaj, ndërsa për punonjësit jo mjek varion 35,000 – 37,200 lekë në muaj.
4. Shtesë për kushte pune. Përfitohet nga disa specialitete si, në kirurgji, ortopedi, pneumoftiziatri, fizioterapi, hematologji, onkologji, radiologji, mjek laborator, mikrobiologji, obstetrikë, mjek peditër në konsultore, mjek peditër pa ngarkesë, kimist, dhe varion nga 1,100 lekë në muaj deri në 1,600 lekë në muaj.
5. Qendrat shëndetësore të cilat kanë Komision Mjeko Ligjor (KML) apo mjekë që janë anëtarë të KML-ve duhet të llogaritin edhe shtesën e pagës për këta punonjës, duke marrë parasysh numrin e personelit të angazhuar në KML dhe shtesën e pagës të përcaktuara në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim, të cilat aktualisht janë:
 - Për kryetarin e KML 2,000 lekë në muaj.
 - Për anëtarin e KML 1,800 lekë në muaj.
6. ***Për qendrat shëndetësore të cilat kanë kontraktuar me Drejtorinë Rajonale të Fondit dhënien e shërbimit të pandërprerë.*** Ato duhet të parashikojnë edhe shtesat mbi pagë që përfiton personeli mjekësor kur jep shërbim të pandërprerë, mbështetur në masën e shpërblimit të përcaktuar në udhëzimin e Fondit. Aktualisht ky shpërblim mbi page është:
 - Kur jepet në ditët e zakonshme 4,000 lekë.
 - Kur jepet ditën e shtunë 3,500 lekë.
 - Kur jepet ditën e diel apo ditë festë 3,000 lekë.

Parashikimi i këtij treguesi bëhet duke marrë në konsideratë kontratën që ka qendra shëndetësore për dhënien e shërbimit të pandërprerë, numrin e ditëve që jepet ky shërbim (pra 365 ditë gjithsej, nga të cilat 14 janë festa zyrtare, 52 ditë të shtuna, 52 ditë të diela) dhe masën e shpërblimit për dhënien e këtij shërbimi.

C) Për personelin infermier

1. Paga e grupit e cila aktualisht varion nga 6,000 lekë në muaj për infermierët me arsim 8/9 vjeçar dhe kurse infermierie deri në 14,000 lekë në muaj për infermierët me master shkencor apo të njehsuar me të sipas ligjit të arsimit të lartë. Në udhëzimin e Fondit është përcaktuar edhe niveli i diplomës që duhet të këtë një punonjës infermier për t'u pozicionuar në një vend pune. Aktualisht, klasifikimi i nivelit të diplomave sipas grupeve dhe paga përkatëse është:
 - Grupi 1 – Master Shkencor 14,000 lekë në muaj.
 - Grupi 2 – Master Profesional 11,000 lekë në muaj.
 - Grupi 3 – Bachelor 10,000 lekë në muaj.
 - Grupi 4 – Diplomë e shkollës mesme për infermier 8,000 lekë në muaj.
 - Grupi 5 – Dëftesë lirimi (arsimi 8/9-vjeçar) dhe kurse infermierie 6,000 lekë në muaj.
2. Shtesë page për vjetërsi në punë është 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Shtesa minimale për efekt të vjetërsisë është për punonjësit që kanë diplomë të grupit 5, pra, 120 lekë në muaj (6,000 x 2%) për punonjësin me vjetërsi pune

1 vit, ndërsa shtesa maksimale i përket punonjësve që kanë diplomë të grupit 1 pra 280 lekë në muaj (14,000 x 2%) për punonjësin me vjetërsi pune 1 vit.

3. Shtesë për pozicion sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e Fondit. Aktualisht, shtesa për pozicion për personelin infermier varion nga 23,700 lekë (ndihmës infermier) në 30,500 lekë në muaj (kryeinfermier).
4. Shtesë për kushte pune. Përfitohet nga infermierët që punojnë në shërbime të specializuara si ortopedi, fizioterapi, hematologji, onkologji, laborant rëntgen, infermier në kirurgjinë vazale dhe varion nga 1,100 lekë në muaj deri në 1,500 lekë në muaj.
5. ***Për qendrat shëndetësore të cilat kanë kontraktuar me Drejtorinë Rajonale të Fondit dhënien e shërbimit të pandërprerë.*** Ato duhet të parashikojnë edhe shtesat mbi pagë që përfiton personeli infermier, kur jep shërbim të pandërprerë, mbështetur në masën e shtesat e përcaktuara në udhëzimin e Fondit. Aktualisht, këto shtesa variojnë nga 1,210 lekë kur shërbimi jepet për 12 orë pa ndërprerje në ditët e zakonshme deri në 2,100 lekë, kur shërbimi jepet 24 orë pa ndërprerje në ditët e diela apo festa.

Parashikimi i këtij treguesi bëhet duke marrë në konsideratë kontratën që ka qendra shëndetësore për dhënien e shërbimit të pandërprerë, numrin e ditëve që jepet ky shërbim (pra 365 ditë gjithsej, nga të cilat 14 janë festa zyrtare, 52 ditë të shtuna, 52 ditë të diela) dhe masën e shpërblimit për dhënien e këtij shërbimi.

6. Shtesë për punën e kryer nga ora 19.00-20.00 e përcaktuar aktualisht në 40 lekë në ditë. Kjo shtesë parashikohet nga qendra shëndetësore e cila e ka të organizuar shërbimin shëndetësor deri në orën 20:00 dhe që nuk ka kontratë me Fondin për dhënie shërbimi të pandërprerë. Masa e shpërblimit për efekt të kësaj shtese nuk duhet të kalojë 20% të pagës për çdo muaj.
7. Shtesë për infermierët që punojnë larg vendbanimit të tyre, aktualisht është 1,000 lekë në muaj.

D) Për punonjësit e tjerë të qendrës shëndetësore

Sipas udhëzimit në fuqi të Fondit në "punonjës të tjerë të qendrës shëndetësore" janë përfshirë, sanitarët, shoferët, operatorët, punonjësit e recepsionit dhe të tjerë. Paga e këtyre punonjësve përbëhet nga këta elemente:

- Paga bazë mujore
- Shtesë page për vjetërsi në punë, e cila llogaritet 1% mbi pagën bazë pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25%. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë, pra pavarësisht pozicionit të punës se ku ka punuar më parë punëmarrësi.
- Shtesë page për vështirësi e dëmshmëri, e cila llogaritet mbi pagën bazë mujore sipas përqindjeve të përcaktuara në udhëzimin e Fondit për çdo pozicion pune.
- Shtesë page për punën e kryer për rastet e urgjencës. Për llogaritjen e kësaj shtese duhet të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës për kohën e punës së kryer jashtë kohës normale të punës. Kjo shtesë nuk duhet të kalojë 20% të pagës mujore për çdo muaj.

- Shtesë page për shoferët e autoambulancave në qendrat shëndetësore të cilat kanë kontratë me Drejtorinë Rajonale/Degën e Fondit për të dhënë shërbim të pandërprerë. Llogaritjet për këtë shtesë bëhen mbi bazën e përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim dhe variojnë nga 1,100 lekë për shërbimin e pandërprerë 12 orësh në ditët e zakonshme deri në 1,870 lekë për shërbimin e pandërprerë 24 orë për ditët e diela e festa.

E) Për punonjësit e administrimit financiar (ekonomistët)

e.1. Ekonomist me kohë të plotë

Ekonomisti do të jetë i punësuar me kohë të plotë në rast se qendra shëndetësore ka 40 punonjës e më shumë. Paga për këta punonjës është fikse në varësi të nivelit të arsimit që ka punonjësi. Mbështetur në udhëzimin në fuqi të Fondit, pagat e ekonomistëve janë si më poshtë:

- Ekonomisti me diplomë Master Shkencor apo të barasvlershme me të sipas ligjit të arsimit të lartë, i punësuar në qendrat shëndetësore (me përjashtim të atyre të punësuar në qendrat shëndetësore 1-10 të qytetit të Tiranës) përfiton një pagë mujore 55,000 lekë.
- Ekonomisti me diplomë Master Profesional apo të barasvlershme me të sipas ligjit të arsimit të lartë, i punësuar në qendrat shëndetësore (me përjashtim të atyre të punësuar në qendrat shëndetësore 1-10 të qytetit të Tiranës) përfiton një pagë mujore 52,000 lekë.
- Ekonomisti me diplomë Bachelor apo të barasvlershme me të sipas ligjit të arsimit të lartë, i punësuar në qendrat shëndetësore (me përjashtim të atyre të punësuar në qendrat shëndetësore 1-10 të qytetit të Tiranës) përfiton një pagë mujore 50,000 lekë.
- Ekonomisti me diplomë të shkollës së mesme apo të barasvlershme me të sipas ligjit të arsimit të lartë, i punësuar në çdo Qendër Shëndetësore përfiton një pagë mujore 38,000 lekë.

Për ekonomistët e punësuar në qendrat shëndetësore 1-10 të Tiranës, niveli i pagave do të jetë në varësi të diplomës që ata kanë dhe shumës së përcaktuar në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim.

e.2. Ekonomist me kohë të pjesshme.

Ekonomisti do të jetë i punësuar me kohë të pjesshme në rast se qendra shëndetësore ka më pak se 40 punonjës. Paga për këta punonjës është në varësi të nivelit të arsimit që ka punonjësi dhe kohës së punës që do të punojë në qendrën shëndetësore, sipas kontratës që lidh drejtori i qendrës shëndetësore me punonjësin. Nuk lejohet që një punonjës të jetë i punësuar me kohë të pjesshme në më shumë se dy qendra shëndetësore. Mbështetur në udhëzimin në fuqi të Fondit koha e punës që kontraktohet me një ekonomist është jo më shumë se 10 ditë punë në një qendër shëndetësore që ka deri në 15 punonjës, deri në 26 ditë punë në një qendër shëndetësore me 40 punonjës e më shumë.

F) Shtesë page për drejtorin e qendrës shëndetësore.

Përveç pagës që përfiton në detyrën që kryen si mjek, punonjësi i emëruar dhe që kryen detyrën e drejtorit të qendrës shëndetësore përfiton një shtesë page sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim. Aktualisht, shtesa e pagës për drejtorin e qendrës shëndetësore varion nga 5,000 lekë në muaj në qendrat shëndetësore që ushtrojnë aktivitetin në njësitë administrative ish-komuna, deri në 20,000 lekë në muaj në qendrat shëndetësore nr.1-10 në qytetin e Tiranës.

Planifikimi i fondit të shpërblimeve

Në Udhëzimin e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 1 datë 03.05.2017 "Për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e qendrave shëndetësore nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor", është përcaktuar se qendrat shëndetësore kanë të drejtë të shpërblejnë punonjësit e tyre për rezultate në punë, rastet e daljes në pension apo sëmundje të zgjatura, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar, me urdhër të drejtorit të qendrës shëndetësore. Sipas VKM-së nr. 929 datë 17.11.2010, përcaktohet:

"Fondi i veçantë, i përlogaritur, përdoret nga drejtuesit e organizatës (në rastin tonë nga drejtori i qendrës shëndetësore) për:

- a) shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë;
- b) shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik;
- c) shpërblime të tjera, të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore;
- ç) dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe për raste të tjera;
- d) veprimtari social-kulturore.

Në pikën 3 të këtij vendimi thuhet:

"...Gjithashtu, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, shpërblimi i punonjësve bëhet i diferencuar, në bazë të performancës së punonjësit, por jo më shumë se **1 (një) pagë mujore në vit**. Ky shpërblim jepet vetëm në muajin dhjetor të vitit aktual".

Në pikën 6 të këtij vendimi thuhet:

"Shpërblimi në fund të vitit i jepet çdo punonjësi buxhetor, **për festat e fundvitit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë**, pavarësisht shpërblimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe përballohet nga fondi faktik i veçantë".

Në pikën 7 të këtij vendimi thuhet:

Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet e:

- vdekjes së punonjësit të institucionit. Pagesa i jepet familjes së punonjësit nga titullari i institucionit në masën e një page mujore, por jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- vdekjes së një anëtari të familjes së punonjësit (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët). Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për çdo rast;

- sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast;
- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore.

Në pikën 8 të këtij vendimi thuhet:

“Në veprimtari me karakter social apo kulturor, që përballohen nga fondi i veçantë, përfshihen ato veprimtari të cilat organizohen vetëm për punonjësit e institucionit, sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit dhe të tjera organizime të realizuara nga institucioni. Në çdo rast, masa e shpenzimit, që mbulohet nga fondi i veçantë për këto veprimtari, nuk duhet të kalojë vlerën e 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për punonjës”.

Pra, qysh në planifikim qendra shëndetësore duhet të mbajë parasysh të gjitha përcaktimet e bëra nga KM lidhur me përdorimin e fondit të veçantë, fondin e përllogaritur të pagave, numrin e punonjësve që dalin në pension vitin pasardhës, numrin e punonjësve që ka qendra shëndetësore, numrin e aktiviteteve social-kulturore që parashikon të realizojë në vitin pasardhës si dhe parashikimin për stimulimin e punonjësve për rezultatet në punë.

Shembull për ilustrimin e përllogaritjes së fondit të pagave e shpërblimeve për vitin pasardhës.

(Në zbatim të udhëzimit të Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 1 datë 03.05.2017 “Për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e qendrave shëndetësore nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor”, dhe vendimit të KM Nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar).

Për qendrën shëndetësore “X” Rajoni Dibër.

Pozicioni gjeografik i QSH-së “zonë kodrinore”

Llogaritja e pagës së drejtorit të QSH-së

Drejtori është mjek i përgjithshëm dhe i familjes, numri i banorëve 2,000 persona për gjithë grupmoshat. Drejtori ka specializim pasuniversitar mjek familje.

1.1. Paga bazë = 14,000 lekë në muaj

1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (Drejtori në 1 Janar të vitit pasardhës bën 20 vjet punë) = 14,000 x 2% x 20 vjet = 5,600 lekë në muaj.

1.3. Shtesë page për specializimin pasuniversitar “mjek familje” = 5,000 lekë në muaj.

1.4. Shtesë për ngarkesën për banorë = 2,000 persona x 10.7 lekë/banorë = 21,400 lekë në muaj.

1.5. Shtesë page për pozicionin gjeografik ku ndodhet QSH-ja (kodrinore, bashki) = 30,000 lekë në muaj.

1.6. Shtesë page si anëtar i KML = 1,800 lekë në muaj.

1.7. Shtesë page për shërbimin e pandërprerë (QSH-ja ka kontratë me Drejtorinë Rajonale për këtë shërbim): 1 ditë shërbime në ditë të zakonshme = 4,000 lekë, 1 ditë shërbime në ditën e shtunë = 3,500 lekë dhe 2 ditë shërbimi ditë e diel dhe festa = 1 x 3,000 lekë = 3,000 lekë. Gjithsej shtesa e pagës për shërbim të pandërprerë = 4,000 + 3,500 + 3,000 = 10,500 lekë në muaj.

1.8. Shtesë page për pozicionin e drejtorit (zonë kodrinore bashki) = 15,000 lekë në muaj.

Paga mujore bruto gjithsej = 14,000 + 5,600 + 5,000 + 21,400 + 30,000 + 1,800 + 10,500 + 15,000 = 103.300 lekë.

Llogaritja e pagës së një mjeku të përgjithshëm në këtë qendër shëndetësore

Mjeku mbulon 2,200 banorë të rritur, nuk ka specializim për mjek familje, pediatër, patolog. Nuk është anëtar i KML.

1.1. Paga bazë = **14,000 lekë në muaj**

1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (Mjeku në 1 Janar të vitit pasardhës bën 10 vjet punë) = $14,000 \times 2\% \times 10 \text{ vjet} = \mathbf{2,800 \text{ lekë në muaj}}$.

1.3. Shtesë page për specializimin pasuniversitar "mjek familje" = **0 lekë në muaj.**

1.4. Shtesë për ngarkesën për banorë = $2,200 \text{ persona} \times 9.7 \text{ lekë/banorë} = \mathbf{21,340 \text{ lekë në muaj}}$.

1.5. Shtesë page për pozicionin gjeografik ku ndodhet QSH-ja (kodrinore, bashki) = **30,000 lekë në muaj.**

1.6. Shtesë page si anëtar i KML = **0 lekë në muaj.**

1.7. Shtesë page për shërbimin e pandërprerë (QSH ka kontratë me Drejtorinë Rajonale për këtë shërbim): 1 ditë shërbimi në ditë të zakonshme = 4,000 lekë, 1 ditë shërbimi në ditën e shtunë = 3,500 lekë dhe 2 ditë shërbimi ditë e diel dhe festa = $2 \times 3,000 \text{ lekë} = 6,000 \text{ lekë}$. Gjithsej shtesa e pagës për shërbim të pandërprerë = $4,000 + 3,500 + 3,000 = \mathbf{13,500 \text{ lekë në muaj}}$.

1.8. Shtesë page për pozicionin e drejtorit (zonë kodrinore bashki) = 0 lekë në muaj.

Paga mujore bruto gjithsej = 14,000 + 2,800 + 0 + 21,340 + 30,000 + 0 + 13,500 = 81,640 lekë.

Llogaritja e pagës së një infermieri në këtë qendër shëndetësore

1.1. Paga e grupit (diplome Bachelor) = 10,000 lekë në muaj

1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (16 vjet punë) = $10,000 \times 2\% \times 16 \text{ vjet} = 3,200 \text{ lekë në muaj}$.

1.3. Shtesë page për pozicion (infermier pranë mjekut të familjes) = 27,500 lekë në muaj.

1.4. Shtesë page për kushte pune = 0 lekë në muaj.

1.5. Shpërblim për largësi nga vendbanimi = 1,000 lekë në muaj.

1.6. Shtesë page për shërbim 24 orësh (qendra shëndetësore ka kontratë me Drejtorinë Rajonale të Fondit): 2 ditë të zakonshme = $2 \text{ ditë} \times 1,650 \text{ lekë në ditë} = 3,300 \text{ lekë në muaj}$; 2 ditë të shtuna = $2 \text{ ditë} \times 1,760 \text{ lekë në ditë} = 3,520 \text{ lekë në muaj}$; 2 ditë të diela e festa = $2 \text{ ditë} \times 2,100 \text{ lekë} = 4,200 \text{ lekë në muaj}$, gjithsej = $3,300 + 3,520 + 4,200 = 11,020 \text{ lekë në muaj}$.

Paga mujore bruto gjithsej = 10,000 + 3,200 + 27,500 + 0 + 1,000 + 0 + 11,020 = 52,720 lekë.

Llogaritja e pagës së një shoferi autoambulance në këtë qendër shëndetësore

- 1.1. Paga bazë mujore = 30,000 lekë në muaj
- 1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (30 vjet punë) = $30,000 \times 1\% \times 25$ vjet = 7,500 lekë në muaj.
- 1.3. Shtesë page për vështirësi e dëmshmëri = $30,000 \times 10\%$ = 3,000 lekë në muaj.
- 1.4. Shtesë page për shërbim 24 orësh (qendra shëndetësore ka kontratë me Drejtorinë Rajonale të Fondit): 4 ditë të zakonshme = 4 ditë x 1,430 lekë në ditë = 5,720 lekë në muaj; 2 ditë të shtuna = 2 ditë x 1,650 lekë në ditë = 3,300 lekë në muaj; 2 ditë të diela e festa = 2 ditë x 1,870 lekë = 3,740 lekë në muaj, gjithsej = 5,720 + 3,300 + 3,740 = 12,760 lekë në muaj.

Paga mujore bruto gjithsej = 30,000 + 7,500 + 3,000 + 12,760 = 53,260 lekë.

Llogaritja e pagës së një sanitareje në këtë qendër shëndetësore

- 1.1. Paga bazë mujore = 26,500 lekë në muaj
- 1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (30 vjet punë) = $26,500 \times 1\% \times 25$ vjet = 6,625 lekë në muaj.
- 1.3. Shtesë page për vështirësi e dëmshmëri = $26,500 \times 20\%$ = 5,300 lekë në muaj.

Paga mujore bruto gjithsej = 26,500 + 6,625 + 5,300 = 38,425 lekë.

Llogaritja e pagës së një operatori në këtë qendër shëndetësore

- 1.1. Paga bazë mujore = 30,000 lekë në muaj
- 1.2. Shtesë page për vjetërsi në punë (15 vjet punë) = $30,000 \times 1\% \times 15$ vjet = 4,500 lekë në muaj.
- 1.3. Shtesë page për vështirësi e dëmshmëri = $30,000 \times 5\%$ = 1,500 lekë në muaj.

Paga mujore bruto gjithsej = 30,000 + 4,500 + 1,500 = 36,000 lekë.

Llogaritja e pagës së një punonjësi recepsioni në këtë qendër shëndetësore

Paga bazë mujore = **30,000 lekë në muaj**
Shtesë page për vjetërsi në punë (10 vjet punë) = $30,000 \times 1\% \times 10$ vjet = **3,000 lekë në muaj.**

Paga mujore bruto gjithsej = 30,000 + 3,000 = 33,000 lekë.

Llogaritja e pagës së ekonomistit në këtë qendër shëndetësore

Qendra shëndetësore ka 30 punonjës, ekonomisti ka diplomë Master Profesional.

Paga bruto mujore për ekonomistin me kohë të plotë (pra kur QSH-ja ka 40 e më shumë punonjës), për ekonomistin me diplomë të nivelit Master Profesional është 52,000 lekë. Sipas tabelës së pagave, me ekonomistin duhet të lidhet kontratë për 18 ditë pune në muaj. Referuar

përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Fondit për këtë qëllim, ekonomisti me kohë të plotë punon 26 ditë në muaj (koha ditore e punës është 6 orë e 40 minuta) për të cilën paguhet me **52,000 lekë në muaj**.

Për rrjedhojë, paga mujore bruto e ekonomistit të kësaj qendre shëndetësore, i cili punon 18 ditë është = $52,000 \text{ lekë/muaj} / 26 \text{ ditë punë në muaj} \times 18 \text{ ditë punë që punon ekonomisti} = \mathbf{36,000 \text{ lekë në muaj}}$.

Mbështetur në udhëzimin aktual të Fondit, llogaritja e fondit të pagave për vitin pasardhës do të bëhet mbështetur në numrin e punonjësve që parashikon të ketë qendra shëndetësore në fund të vitit aktual, numrin e banorëve që mbulon qendra dhe sipas vlerave për çdo element të pagës të parashikuar në udhëzim. Do të llogaritet vetëm efekti i shtesës së pagës për elementin vjetërsi pune, konkretisht:

Për një mjek të përgjithshëm, i cili në vitin aktual ka një vjetërsi pune prej 15 vjetësh dhe shtesa e pagës për vjetërsi është $14,000 \times 2\% \times 15 \text{ vjet} = 4,200 \text{ lekë në muaj}$ ose $50,400 \text{ lekë në vit}$, për vitin pasardhës vjetërsia në punë e mjekut bëhet 16 vjet në muajin Korrik, atëherë shtesa e pagës për vjetërsi pune për vitin pasardhës do të jetë:

Shtesa e pagës për periudhën 1 Janar - 30 Qershor = $14,000 \times 2\% \times 15 \text{ vjet} = 4,200 \text{ lekë në muaj} \times 6 \text{ muaj} = 25,200 \text{ lekë}$.

Për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor = $14,000 \times 2\% \times 16 \text{ vjet} = 4,480 \text{ lekë në muaj} \times 6 \text{ muaj} = 26,880 \text{ lekë}$.

Pra për vitin pasardhës shtesa e pagës për efekt të vjetërsisë në punë do të jetë = $25,200 + 26,880 = 52,080 \text{ lekë}$ ose $1,680 \text{ lekë më shumë se viti aktual} (52,080 - 50,400)$.

Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe për llogaritjen e shtesës së pagës për efekt të vjetërsisë në punë për personelin tjetër, mbështetur në periudhën kur plotësohet rritja e vjetërsisë në punë në vitin pasardhës.

Llogaritja e fondit të veçantë

Planifikimi i fondit të veçantë bëhet mbi fondin e planifikuar të pagave për vitin pasardhës. Konkretisht, në qoftë se qendra shëndetësore ka 21 punonjës dhe fondi i planifikuar i pagave është $11,000,000 \text{ lekë}$ atëherë fondi i veçantë do të parashikohet në shumën **550,000 lekë** ($11,000,000 \times 5\%$).

Ky fond duhet të detajohet:

- shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik, 21 punonjës $\times 10,000 \text{ lekë/punonjës} = \mathbf{210,000 \text{ lekë}}$,
- dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe për raste të tjera. Këtu mund të parashikohen vetëm rastet e daljes në pension pleqërie, konkretisht për vitin pasardhës dalin në pension pleqërie 1 mjek, paga e të cilit është $65,000 \text{ lekë}$ dhe 1 infermier, paga e të cilit është $39,000 \text{ lekë}$, atëherë nga fondi i veçantë parashikohet të përdoret fondi prej **104,000 lekë**,

- veprimtari social-kulturore. Qendra shëndetësore parashikon të zhvillojë një aktivitet për festat e fundvitit. Atëherë fondi i veçantë për këtë qëllim do të jetë 21 punonjës x 2,500 lekë/punonjës = **52,500 lekë**,

Fondi i veçantë që parashikohet të përdoret për shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë dhe shpërblime të tjera, të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore do të jetë **183,500 lekë** (550,000 – 210,000 – 104,000 – 52,500).

Llogaritjet e mësipërme janë kryer mbështetur në përcaktimet e bëra në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar) dhe fondin e pagave të planifikuar për qendrën shëndetësore me 21 punonjës.

Gjithsej, fondi i pagave e shpërblimeve (analiza 600) për këtë qendër shëndetësore për vitin pasardhës do të jetë **11,550,000 lekë** (11,000,000 + 550,000).

Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (analiza 601) që do të paguajë punëdhënësi për vitin pasardhës.

Llogaritja e kontributeve bëhet mbi fondin e pagës mbi të cilin paguhen këto kontribute, konkretisht fondi i planifikuar i pagave është 11,000,000 lekë x 16.7% (përqindje e parashikuar nga legjislacioni në fuqi) rezulton që shuma e kontributeve të parashikuara për vitin pasardhës do të jetë **1,837,000 lekë**.

Llogaritja e shpenzimeve korente (analiza 602) për vitin pasardhës

Planifikimi i shpenzimeve operative kryhet duke pasur parasysh aktivitetin që planifikohet të realizohet në qendrën shëndetësore vitin e ardhshëm.

Planifikohet buxhet për çdo lloj shpenzimi të nevojshëm parashikuar në klasifikimin ekonomik me nënartikuj.

- Planifikimi i buxhetit për barna dhe materiale mjekësore përbën zërin më të rëndësishëm të shpenzimeve operative. Parashikimi i shpenzimeve për këtë zë duhet të ketë parasysh së pari listën e medikamenteve që duhet të ekzistojë në çdo qendër shëndetësore, së dyti gjendjen e medikamenteve në magazinë, së treti gjendjen e medikamenteve në çdo ambulancë si dhe së katërti aktivitetin që parashikohet të ketë qendra shëndetësore për vitin në vazhdim. Nga grupi i punës duhet të administrohen të dhënat e mëposhtme:
 - sasi të e barnave dhe materialeve mjekësore të konsumuara në vitin paraardhës,
 - sasi të e barnave e materialeve mjekësore të konsumuara në 6-mujorin e parë të vitit aktual,
 - sasi të e barnave e materialeve mjekësore që parashikohet të konsumohet për gjithë vitin aktual,
 - gjendjen e barnave e materialeve mjekësore në çdo ambulancë dhe magazinën e qendrës shëndetësore në fund të vitit aktual.
 - kërkesat e çdo ambulance për blerjen e barnave e materialeve mjekësore për vitin pasardhës.

Të gjitha këto të dhëna duhet të jenë të dokumentuara e nënshkruara nga personat përgjegjës. Mbi bazën e këtyre të dhënave (sasi të dhe çmimet e vitit aktual) grupi i punës përgatit bilancin material sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emërtimi i barnave dhe materialeve mjekësore	Njësia	Çmimi njësi	Gjendja në fund të vitit aktual (sasi)	Kërkesat për blerje për vitin pasardhës (sasi)	Nevojat për vitin pasardhës	
						sasi	vlerë
a	b	1	2	3	4	5 = (4 - 3)	6 = 5 x 2

Grupi i punës duhet të analizojë të gjitha të dhënat që grumbullon nga ambulancat lidhur me kërkesat që ata paraqesin për blerjen e barnave e materialeve mjekësorë. Kështu, në qoftë se kërkesa për "X" medikament është shumë më e lartë se konsumi i vitit aktual, grupi i punës duhet të bëjë korrektimet përkatëse me qëllim që parashikimi për vitin pasardhës të jetë sa më real.

